

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit F. A. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), sipas propozimkuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.29/2016, e datës 14.01.2016, më datën 03.02.2015, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit F. A., i lindur më ..., në K., tani me vendbanim në Gj. , rr” ... ” L.A. ”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i cili

Është fajtor

Sepse me datën ..., rreth orës ... minuta, në rrugën e rë për tej “...”, në fsh.P., i pandehuri sa drejtonte veturën e markës “...”, të tipit ... , me tab.regj. ..., nga pakujdesia ka shkel Ligjin mbi sigurimin e Komunikacionit Rrugor nga neni 54.1, mos përshtatja e shpejtësisë kushteve të komunikacionit rrugorë, posaqërisht duke pasur parasyshë pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet atmosferike, e që në rastin konkret ishte rrugë e ngrirë e rrëshqitshme dhe me mjegull, dhe me atë rast humbë kontrollin dhe del jashtë rruge në anën e majtë, dhe bie në një kanal me qrast përpos dëmeve materjale në automjet, lëndime të lehta trupore pëson edhe pasaxheri-i dëmtuari D. I., i cili për shkak lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkoj ndimë mjeksore në Spitalin Regjional të Gjilanit- Qendra Emergjente.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 41, 46, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit F. A. P. H., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

I dëmtuari D. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, si dhe shpenzimet tjera, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur propozim akuzën e lartcekur ndaj të pandehurit F. A. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, , **nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.**, i cili ka hyrë në fuqi më 06.04.2004. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi propozim akuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit F. A. dhe të njëjtit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në propozim akuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Gjyqtari, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike penale, duhet të aplikohet Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013, ngase konsiderohet ligj më i favorshëm për të pandehurin, për faktin se për këtë formë të kësaj vepre penale ka parashikuar dënim më të butë.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, raporteve mjekësore, mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko-ligjor lidhur me natyrën e lëndimeve trupore, skicës

nga vendi i ngjarjes, fotografive që gjenden në shkresa të lëndës, raporteve të oficerëve policor, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri F. A. nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 495 paragrafi 1 lidhur me nenin 365 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më .03.02.2016

**Sekretarja juridike,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.